



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 991 Prot.

Korçë më 03.05. 2024

VENDIM

Nr. 231, datë 03.05.2024

PER
SHPALLJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR
AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI",
KORÇË

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UNIKO", "; Kreu IV "Regjistrimi i kandidatëve", neni 18, pika 1 dhe 2, neni 6, pika 2, germa g, neni 7, pika 7 germa d, KIZ në mbledhjen e datës 03.05.2024.

VENDOSI:

1. Të shpallë procesin e regjistrimit të kandidatëve për REKTOR, ANËTAR SENATI AKADEMIK, DEKAN i njësisë kryesore dhe PËRGJEGJËS I NJËSISË BAZË sipas kriterëve bashkëngjitur vendimit.
2. Regjistrimi i kandidatëve fillon më datë 07.05.2024. ora 08:00 dhe përfundon më datë 11.05.2024 ora 16:00.
3. Kërkesat e kandidatëve për Rektor dhe Anëtar Senati Akademik do të dorëzohen pranë sekretarit të KIZ nga data 07.05.2024. ora 08:00 deri më datë 11.05.2024 ora 16:00.
4. Kërkesat e kandidatëve për Dekan dhe Përgjegjës të njësive bazë do të dorëzohen pranë sekretarit të KZF-së përkatëse të fakultetit nga data 07.05.2024. ora 08:00 deri më datë 11.05.2024 ora 16:00.
5. Ngarkohen anëtarët e KIZ për publikimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohen KZF-të për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioni Institucional Zgjedhor

- BLENDI BAZE (Kryetar)
- JULIAN SHISHI (Anëtar)
- KLAUDIA LIPI (Anëtar)
- KATERINA PIKULI (Anëtar)
- FJORELA BAJRAKTARI (Student)



DOKUMENTACIONI PËR KANDIDIDIM

- a) Kërkesën për kandidim e cila përmban: emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Kopje të noterizuar të gradës/titullit akademik;
- d) Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar.
- e) Formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ/KZF) për:
 - Deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje pavarësisht kohëzgjatjes si autoritet drejtues në postin për të cilin kandidon në Universitetin “Fan S. Noli”;
 - Deklarimin për përmbushjen e kriterëve për kandidim;
 - Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
 - Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Dokumentet e kandidimit për studentët anëtarë të Senatit Akademik dorëzohen në KIZ dhe përmbajnë:

- a- Kërkesën për kandidim e cila përfshin, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b- Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c- Vërtetim që vërteton se është student me kohë të plotë në Universitetin “Fan S. Noli”;
- d- Propozimi nga jo më pak se 30 studentë pjesë e trupës zgjedhore;

